



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 569/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për ankesën e organizatës Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuëse (BIRN) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Mustafë Deliut në cilësinë e kryesuesit të Vendvotimit (VV-së) nr. 0801c/13d në Klinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET si e pabazuara ankesa e organizatës Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuëse BIRN.

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga organizata BIRN, me te cilën pretendohet se në Qendrën e Votimit nr. 0801c/13d në shkollën fillore “Ismet Rraci” në Klinë, sipas parashtruesit të ankesës në këtë VV ka pasur votim të dyfishtë dhe është bërë keqpërdorim me 178 vota që kanë qenë me kusht.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh, se pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se është bërë shkelja e theksuar në ankesë janë te pabazuara nga shkaku se nuk është ofruar dëshmi për të besuar se ka ndodhur shkelja e tillë. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 569/2010 më datën 16.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

